



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:010095

Datë: 13.06.2018

Numri i dokumentit: 00060768

PKR.nr.111/17

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, kryetari i trupit gjykues Artan Sejrani, me gjyqtarët Ajser Skenderi dhe Fatmir Krasniqi si anëtare të trupit gjykues, me procesmbajtësen Florije Kolukaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit I.B nga Komuna e Prizreni, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 lidhur me parag. 2 nën parag. 2.4 të KP-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, PP/l.nr.37/17 të datës 30.10.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, në praninë e Prokurorit të shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarit dhe mbrojtësit të akuzuarit av. M.Q nga Prizreni, me datën 25.05.2018 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

I.B, nga i ati S., dhe e ëma K., e lindur M., i lindur me datë ..., Komuna e Prizrenit, ku edhe tani jeton, ka të kryer shkencat politike - drejtimi i administratës, ish drejtor i administratës publike në Komunën e Prizrenit, i martuar, babë i një femiju, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal...

Ë S H T Ë F A J T O R Ë

Se në periudhën kohore gusht të vitit 2015 deri në dhjetorë të vitit 2016, i akuzuari në cilësinë e drejtorit të administratës publike pranë Komunës së Prizrenit duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij zyrtare duke keqpërdorur pasurinë publike me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për të tjerët TV Opinon, TV Besa dhe TV Prizreni në atë mënyrë që pa ndonjë procedurë të tenderimit lidh dhe nënshkruan kontratat për emitimin e spoteve reklamuese në lidhje me aplikimet online për nevojat e komunës së Prizrenit gjegjësisht të administratës publike ashtu që me TV Opinon lidh kontratën për transmertim me dt. 01.08.2015, deri me 31.07.2016, në vlerë prej 300 euro në muaj, me TV Besa lidhë kontratë me datën 01.09.2015, deri me dt. 01.08.2016 në vlerë prej 250 euro në muaj dhe me TV Prizrenin lidh kontratë me dt. 01.04.2016 e cila do të zgjasë deri me datën 31.12.2016 në shumën prej 500 euro në muaj, ndërsa pas ekspertizës së kryer financiare ka rezultuar se në bazë të kartelave të

furnitorve të tre TV të lartpërmendura për shërbimet e spoteve reklamuese lidhur me aplikimet online janë tejkualuar shumat e parashikuara me kontrata të nënshkruar e cila arrinë shumën prej 17.100 euro.

- Këso dore ka kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 lidhur me parag. 2 nën parag. 2.4 të KP-së.

Gjykata në bazë të nenit 7, 8, 9, 10, 21, 27, 41, 42, 49, 50, 51, 52, 73, nenit 422 parag.1 lidhur me parag. 2 nënparag. 2.4 të KP-së dhe nenit 365 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

- Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 /një/ viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në qoftë se i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës të paguaj paushallin gjyqësor në lartësi prej 200 euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumën prej 50 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.37/17 të datës 30.10.2017, kundër të akuzuarit I.B nga Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 lidhur me parag. 2 nën parag. 2.4 të KP-së.

Prokurori i shtetit Mehdi Sefa në fjalën përfundimtare ndër të tjera ka deklaruar se kjo gjendje faktike në tërësi është vërtetuar edhe nga administrimi i provave para trupit gjykues në veçanti nga kontratat e nënshkruar këtu të akuzuarit I.B me këto TV lokale ku shihet shuma dhe afatet e kontratave të lidhura po ashtu nga ekspertizat që janë administruar dhe nga ekspertet që janë dëgjuar si hartues të këtyre eksperti financiar A.Sh si dhe eksperti B.U është vërtetuar pa mëdyshje se pavarësisht faktit se këto kontrata në këto TV lokale janë nënshkruar dhe përpiluar nga këtu i akuzuari I.B, paraja publike nuk është nënshtruar ligjeve të konkurrencës gjegjësisht procedurës së tenderimit ashtu si e kanë gjetur që të dy ekspertet edhe eksperti i caktuar nga prokuroria por edhe eksperti që e ka propozuar pala mbrojtëse, me çrast njeri ekspert ka gjetur se kemi të bëjmë me një tejkualim të shumës e cila arrinë shumën prej 34.500 euro, ndërsa eksperti tjetër B.U 17.100 euro. Pra konsiderojmë se këtu i akuzuari I.B pavarësisht faktit se ka pasur njohuri se çdo para publike i nënshtrohet procedurës së tenderimit ka anashkualuar zyrën e prokurimit komunal dhe kështu duke e shfrytëzuar autoritetin e tij zyrtar ka tejkualuar kompetencat e tij duke nënshkruar këto kontrata me këto TV lokale, krejt me qëllimit të përfitimit të dobisë pasurore për këto TV lokale ose operator ekonomik. Mbrojtja e tij se këto kontrata ai nuk ka hartuar dhe se janë hartuar nga zyra e prokurimit publik nuk ka gjetur mbështetje në prova materiale me që pala mbrojtëse nuk ka propozuar asnjë zyrtar të prokurimit publik të cilët kanë qenë hartues të këtyre kontratave po ashtu mbrojtja e tij se kemi të bëjmë me ndonjë subjekt

gjegjësisht një post politik nuk e arsyeton faktin e përgjegjësisë së tij me që vetë këtu i akuzuari I.B ka deklaruar se i njeh mirë dispozitat e ligjit mbi prokurimin publik ku ka theksuar se çdo shumë përtej njëmijë euro i nënshtrohet procedurave të tenderimit gjegjësisht për lidhjen e kontratave për shumat mbi njëmijë euro, është dashur që të shkoj përmes zyrës së prokurimit publik, andaj konsiderojmë se në veprimet e tij formohen elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës dhe propozoj gjykatës, trupit gjykues që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoj sipas ligjit për veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit nga neni 422 parag. 1 lidhur me parag. 2 nën parag. 2.4 të KP-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit I.B av. M.Q fjalën përfundimtare gjykatës ia ka parashtruar me shkrim, në të cilën ndër të tjera ka deklaruar se në këtë çështje penale, i akuzuari që nga fillimi i procedurës nuk ka mohuar se ka nënshkruar kontrata me TV lokale, TV Besa, TV Opinioni dhe TV Prizreni e të cilat kontratat janë prezantuar si provë dhe janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. I akuzuari deklaroi se këto kontrata i ka nënshkruar i sigurt që janë në pajtim me ligjin nga se pagesat në shumat që nuk kalojnë vlerën prej 990 euro, nuk duhen ti nënshtrohen procedurave të prokurimit. Prokuroria është mbështetur në kontratat dhe në raportin e auditorit të brendshëm duke vepruar në bazë të kallëzimit penal të ushtruar nga policia e Kosovës ka ngritur edhe këtë aktakuzë. Provat e administruara kanë vërtetuar se aktakuza nuk është e bazuar nga se nuk janë përmbushur elementet qenësore të veprës penale për të cilën ngarkohet. Në këtë çështje penale janë përpiluar dy ekspertiza dhe se eksperti B.U në ekspertizën me shkrim dhe në deklarinë që ka dhënë në seancën gjyqësore ka sqaruar përfundimisht se eksperti A.Sh ka gabuar në konstatimin e tij në ekspertizë. Sqaruar këto dy fakte të paraqitura në ekspertizën e ekspertit B.U del se eksperti ka vërtetuar faktin kryesor në këtë çështje penale, se i akuzuari nuk ka pas mundësi ta dijë as që e ka ditë që këto kontrata duhen të kalojnë në procedurë të prokurimit dhe se zyra e thesarit ka pas për obligim me i verifikuar se urdhrat për pagesë janë në pajtim me ligjin ose jo, me vetë lejin e pagesës le të kuptoj se këto kontrata janë të ligjshme. Ky ekspert në ekspertizën e tij ka sqaruar edhe lartësinë e shumave të cilat janë paguar në emër të kontratave. Pavarësisht faktit se i akuzuari ka nënshkruar kontratat për blerjen e shërbimeve në TV lokale në Prizren, pastaj faktin të cilin nuk e mohon që për këto kontrata nuk janë zbatuar procedurat e prokurimit. Por mungon elementi qenësor i kësaj veprë penale i cili është dashja që në rastin konkretë nuk ekziston. Prandaj nga të lartë cekurat konsideroj se në këtë rast për veç se nuk janë plotësuar tiparet e veprës penale të përcaktuara me ligj për veprën penale keqpërdorimi i pozitës, apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 të KP-së nuk janë plotësuar as kushtet nga neni 7 i KP-së. Me asnjë provë nuk është arrit të vërtetohet dashja, qoftë ajo direkte apo eventuale, për vetë faktin se i akuzuari duke vepruar në lidhje me kontratat për të cilat ngarkohet në aktakuzë nuk ka qenë i vetëdijshëm se është duke kryer veprën penale, prandaj i propozoj gjykatës që të akuzuarin ta liroj nga aktakuza.

I akuzuari I.B në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi e mbështetë fjalën përfundimtare të mbrojtësit av. M.Q, dhe shton se katalogu është i Qeverisë së Republikës së Kosovës që e bënë riorganizimin dhe përshkrimin e detyrave të vendit të punës për secilin të punësuar në institucionin publik dhe dokumenti i dytë është i aprovuar në asamblen komunale e njëjta e cila e bënë përshkrimin e detyrave të punësuarve të Komunës.

Gjykata sipas detyrës zyrtare dhe atë konform nenit 257 të KPP është kujdesur lidhur me pranueshmërinë e provave dhe se në rastin konkret nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme në këtë çështje penale dhe se të gjitha provat që mbështetet akuza janë marr në pajtim me dispozitatat e KPP-së.

Duke vlerësuar provat e administruara në procedurë për të akuzuarin, në pajtim me nenin 8 dhe nenin 361 të KPP-së, gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se në periudhën kohore gusht të vitit 2015 deri në dhjetorë të vitit 2016, i akuzuari në cilësinë e drejtorit të administratës publike pranë Komunës së Prizrenit duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij zyrtare duke keqpërdorur pasurinë publike me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për të tjerët TV Opinon, TV Besa dhe TV Prizreni në atë mënyrë që pa ndonjë procedurë të tenderimit lidh dhe nënshkruan kontratat për emitimin e spoteve reklamuese në lidhje me aplikimet online për nevojat e komunës së Prizrenit gjegjësisht të administratës publike ashtu që me TV Opinon lidh kontratën për transmertim me dt. 01.08.2015, deri me 31.07.2016, në vlerë prej 300 euro në muaj, me TV Besa lidhë kontratë me datën 01.09.2015, deri me dt. 01.08.2016 në vlerë prej 250 euro në muaj dhe me TV Prizrenin lidh kontratë me dt. 01.04.2016 e cila do të zgjasë deri me datën 31.12.2016 në shumën prej 500 euro në muaj, ndërsa pas ekspertizës së kryer financiare ka rezultuar se në bazë të kartelave të furnitorve të tre TV të lartpërmendura për shërbimet e spoteve reklamuese lidhur me aplikimet online janë tejkaluar shumat e parashikuara me kontrata të nënshkruar e cila arrinë shumën prej 17.100 euro.

Gjendjen e këtillë faktike gjykata e ka vërtetuar nga dëshmia e ekspertëve A.Sh, B.U dëshmitares S.U, mendimi i ekspertit financiar A.Sh, kontrata TV Prizrenit lidhur me drejtorinë e administratës publike e datës 01.04.2016 - 31.12.2016, kontrata për transmetim me TV Opinon e datës 01.08.2015, kontrata mbi ofrimin e shërbimeve reklamuese TV Besa e datës 01.09.2015, raporti i auditimit për pasqyrat financiare të KK Prizrenit me numër 22.18.1-2015 - 08 për vitin 2015, kartela e furnitorëve lidhur me pagesat me TV Besën, TV Prizrenin dhe TV Opinionin, mendimi i ekspertizës së ekspertit financiar B.U e datës 26.04.2018, dhe mbrojtja e të akuzuarit.

Eksperti A.Sh në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se ka hartuar një ekspertizë, e gjithë ekspertiza bazohet në dokumentet përkatëse nga fillimi deri në mbarim. Ligji i menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi 03L/048 përcakton përgjegjësitë në organizatat buxhetore lidhur me shpenzimin e parasë publike, njëkohësisht përveç këtij ligji në mënyrë eksplicite, shpenzimin e parasë publike e trajton ligji i prokurimit publik dhe njëkohësisht edhe rregullat dytësore për prokurim publik dhe legjislacionin sekondar dhe njëkohësisht edhe rregulloren të thesarit. Bazuar në nenin 26 të Ligjit për person kompetent për nënshkrimin e kontratave publike në autoritetet kontraktueses për furnizim me mallra shërbime dhe investime kapitale është personi përgjegjës apo zyrtari i prokurimit, në kuadër të autoritetit kontraktues, për çdo kontratë që nënshkruhet nga kush do tjetër për veç zyrtareve kompetent që i nënshkruan kontrata çfarë do qofshin ato që takon kontrata të fushës së shërbimeve apo investimeve kapitale konsiderohen kontrata jo ligjore, që do të thotë se edhe për shërbimet për imitim të spoteve televizive varësisht nga vlera e planifikuar e buxhetit duhet ndjekur procedurat ligjore të përcaktuar për ligjin për prokurim publik që do të thotë që edhe për këto shërbime duhet nënshtruar konkurrencës së lirë, paraprakisht duhet bërë një

njoftim për kontratë, duhet përcaktuar kushtet për blerjen e këtyre shërbimeve, njëkohësisht duhet caktuar kriteret që duhen të përmbushen kontraktorët dhe njëkohësisht çdo shërbim që realizohet paraprakisht duhet me ju përmbajte kushteve të kontratës pra thjesht një autoritet kontraktues qoftë Komuna, ministri apo ndërmarrje publike që shpenzon fondet publikë, njëkohësisht ka obligim dhe detyrim ligjor që ti ndjekë procedurat e ligjit të prokurimit publik në mënyrë që përmbushet një termë që përdorët vlera për para, që në kuptim të nenit 6 të LPP-së, në emër të ekonomicitetit duhet nënshtruar transparencës. Çdo autoritet kontraktues në rastin konkretë që është Komuna e Prizrenit në kuadër të strukturës së vetë organizative ka një departament apo zyre të prokurimit përmes së cilës çdo njësi kërkuese duhet që shërbimet apo furnizimet ti realizoj përmes kësaj zyre, kontrata të tilla duhen të nënshkruhen vetëm nga menaxher i prokurimit, sipas ligjit mbi financat publike dhe rregullores së thesarit 01/2013 , shpenzimi i parave publike për kategorinë mallra dhe shërbime bëhet në dy mënyra, mënyra e parë janë shërbimet komunale, të cilat nuk ka nevojë të zbatohet procedura të tenderimit dhe se këto paguhen në mënyrë direkte, ndërsa shpenzimet tjera shërbime me mallra, është ligjore të ndjekin procedurat të tenderimit dhe se për këto shërbime pagesat nuk bëhen përmes urdhër blerjes për shpenzim, po bëhen përmes kërkesës për blerje, pra në momentin kur zbatohet kërkesa për blerjen automatikisht për këto procedura pra duhet ndjekur apo publikuar një ftesë për ofertim. Komuna e Prizrenit me datën 19.01.2016, me vendim të drejtorisë për buxhet dhe financa ka aprovuar mjete financiare, për shërbimet e reklamave për TV Opinion, TV Besa dhe TV Prizreni, kërkesa fillimisht është miratuar si shumë nga 300 euro, për secilin TV. Në bazë të kësaj drejtori i administratës me datë 09.01.2015 ka lidh kontratë me TV Besa, në shumë prej 250 euro, për reklamim apo emetim të spoteve mujore me 15 përsëritje në ditë, njëkohësisht me datën 01.04.2016, deri me 31.12.2016, është lidhur kontrata me TV Prizreni, në shumë mujore nga 500 euro, njëkohësisht me datën 01.08.2015, deri me datën 31.07.2016 është lidhur kontrata nga drejtori i administratës me TV Opinionin në shumë prej 300 euro, në baza mujore për emetim apo transmetim për pesë spoteve ditore për gjashtë muaj, pra këto kontrata janë lidh në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe se këto shërbime është dashur të realizohen përmes zyrës së prokurimit që nën kupton nënshtrimin të konkurrencës dhe transparencës.

Duke analizuar dëshminë e ekspertit A.Sh është vërtetuar fakti se procedura e lidhjes së kontratave me TV Lokale nga i akuzuari dhe ekzekutimi i pagesave është bërë pa kurrfarë procedure të prokurimit dhe se këto shërbime është dashur të realizohen përmes zyrës së prokurimit që është dashur ti nënshtrohet konkurrencës dhe transparencës. Kjo dëshmi përkon në tërësi edhe me dëshminë e ekspertit B. U. i cili ka theksuar se pa kurrfarë procedure të prokurimit janë lidhur kontratat gjë që është shkelur ligji i prokurimit. Po ashtu kjo dëshmi është në harmoni edhe me provat materiale të cilat janë administruar. Nga këto arsye gjykata ia falë besimin e plotë kësaj dëshmie.

Eksperti B.U në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se qëndroj në tërësi pranë ekspertizës të dhënë me shkrim. Ekspertiza e përpiluar nga ky ekspert dallon vetëm në kuptim të shumës. Sipas ekspertizës së parë i akuzuari është ngarkuar me të gjithë shumën të cilën KK Prizren respektivisht të gjitha drejtorit të Komunës së Prizrenit për emetimin e spoteve i ka angazhuar tri TV lokale, TV Besa, TV Opinioni dhe TV Prizrenin, shuma e përgjithshme ka qenë 75.400 euro, ndërsa në plotësim të ekspertizës nga i njëjti ekspertë kjo shumë është zvogëluar prapë në shumë prej 35.400 euro, sipas të

gjeturave drejtori i administratës së përgjithshme ka bërë pagesën në emër të TV të përmendurave në shumë të përgjithshme prej 17.100 euro. Nga të cilat 15.000 euro kanë të bëjnë me emetimin e spoteve për këtë drejtori, ndërsa 2100 euro kanë të bëjnë me zyrën për informim, nga e gjithë shuma e angazhimit të TV përkatëse të të gjitha drejtorive të Komunës së Prizrenit rreth 22% kanë të bëjnë në drejtorinë e administratës së përgjithshme. Kontratat janë lidhë në shumë mujore, p.sh kontrata me TV Opinon është cekur shuma mujore prej 300 euro, mirëpo afati i kontratës është 12 muaj, askund në kontratë nuk është cekë shuma totale, kjo kopje e kontratës vazhdimisht është bashkangjitur me urdhëresat për pagesë të thesarit. Të gjitha këto pagesa janë bërë pa i respektuar procedurat e prokurimit, e për të cilat pagesa është dashur të bëhet procedura e tenderimit.

Duke analizuar dëshminë e ekspertit B.U është vërtetuar fakti se procedura e lidhjes së kontratave me TV Lokale nga i akuzuari dhe ekzekutimi i pagesave është bërë pa kurrfarë procedure të prokurimit dhe se këto shërbime është dashur të realizohen përmes zyrës së prokurimit që është dashur ti nënshtrohet konkurrencës dhe transparencës. Kjo dëshmi përkon në tërësi edhe me dëshminë e ekspertit A.Sh i cili ka theksuar se pa kurrfarë procedure të prokurimit janë lidhur kontratat gjë që është shkelur ligji i prokurimit ndërsa vetëm sa i përket shumës së pagesave dallojnë këto dy mendime. Kjo dëshmi është në harmoni edhe me provat materiale të cilat janë administruar. Nga këto arsye gjykata ia falë besimin e plotë kësaj dëshmie.

Dëshmitarja S.U në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera ka theksuar se punon në zyrën e thesarit pranë Komunës së Prizrenit dhe se detyrat e saja janë, zbatimin e ligjit, bëjnë zotimet dhe vendimet e kryetarit. Të gjitha pagesat i lejojmë me vendim të kryetarit. Pagesat që janë me tender ato janë zotimi, urdhër blerja, fatura, kontrata, pranimi i mallit dhe në fund certifikues, kurse ato që janë pa tenderë janë, vendimi i kryetarit varësisht çfarë pagese është, nëse është një shërbim është marrëveshja e drejtorisë me operatorin ekonomik ose edhe vendimi i kryetarit nëse ka nevojë. Në vitin 2015- 2016 janë certifikuar - lejuar pagesat për TV lokale për transmetimin e TV për nevojat e komunës. Detyrat e saj kanë qenë që ta verifikoj dokumentacionin dhe pas verifikimit të dokumentacionit është vendimi i kryetarit atëherë bëhet edhe ekzekutimi i asaj pagese.

Duke analizuar dëshminë e dëshmitares S.U është vërtetuar se në vitin 2015-2016 janë lejuar pagesat për TV lokale për transmetimin e spoteve për nevoja të komunës. Dokumentacionit i është bashkangjitur marrëveshja - kontrata e drejtorisë me operatorin ekonomik dhe është ekzekutimi i pagesave pa kurrfarë procedure të prokurimit. Kjo dëshmi përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj dëshmie.

Nga mendimi i ekspertit financiar A.Sh, është vërtetuar se shpenzimet që lidhen me reklamat janë bërë në kundërshtim të plotë me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi nr.03L/048 neni 17 pika 1 pasi parat publike do të përdorën vetëm për qëllim të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizata buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyre të pa rregullt. sipas nenit 20 te Rregullores 01/2013 mbi shpenzimin e parasë publike zyrtarët e prokurimit do ta bëjnë prokurimin konform dispozitave të ligjit mbi prokurimin publik të Kosovës nr.04/L-042 dhe LMFFPP-së. Me këtë rast nga ana e komunës janë shmangur procedurat e prokurimit publik dhe AK ka bërë shpenzim pa

përfill asnjë aspekt të LPP-së dhe me këtë rast ka bërë pagesa në emër të reklamave pa ndjekur procedurat e nevojshme. Kontratat për shërbime të reklamave janë bërë nga personi jo përgjegjës madje në kundërshtim të plotë në nenin 26 të LPP-së. Përveç që nuk janë përfillë procedurat e LPP kontrata janë tejkaluara shumëfish me shumë se sa vlera e parashikuar e tyre. edhe ato kontrata të nënshkruara nuk përmbajnë të dhëna lidhur me shërbimet e realizuara pasi që kontrata nuk përmban dispozita ligjore që përcaktojnë se cilat janë obligimet dhe përgjegjësitë e TV lokale me rastin e emetimit apo dizajnit të spoteve televizive dhe ka raste edhe pse kontrata ka qenë 500 euro për një muaj pagesa me TV Prizren ka qenë 800 euro për një muaj, që do të thotë se ka pasur parregullsi që nga autorizimi i shpenzimeve e deri të certifikimi i tyre, madje tek shpenzimet për tri TV lokale zyrtari autorizues ka qenë I.B i cili njëkohësisht ka qenë edhe nënshkruar i kontratave të lartë cekura. Kjo provë përkon me dëshminë e ekspertit B.U dhe me provat tjera të administruara. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove.

Nga kontrata TV Prizrenit lidhur me drejtorinë e administratës publike e datës 01.04.2016 - 31.12.2016, është vërtetuar se kontrata është e nënshkruar në mes të TV Prizrenit, në cilësinë e punë kryesit, të cilin e përfaqëson M.B dhe Administrata Komunale në Prizren, në cilësinë e punëdhënësit, të cilin e përfaqëson drejtori I.B . Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove.

Nga kontrata për transmetim me TV Opinion e datës 01.08.2015, është vërtetuar se kontrata është e nënshkruar në mes të TV Opinionit, në cilësinë e punë kryesit, të cilin e përfaqëson drejtori E.K dhe Administrata Komunale në Prizren, në cilësinë e punëdhënësit, të cilin e përfaqëson drejtori I.B. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove.

Nga kontrata mbi ofrimin e shërbimeve reklamuese TV Besa e datës 01.09.2015, është vërtetuar se kontrata është e nënshkruar në mes të TV Besa, në cilësinë e shfrytëzuesit të shërbimeve, të cilin e përfaqëson M.F dhe Administrata Komunale në Prizren, në cilësinë e ofruesit të shërbimeve, të cilin e përfaqëson drejtori I.Bj. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove.

Nga raporti i auditimit për pasqyrat financiare të KK Prizrenit me numër 22.18.1-2015 - 08 për vitin 2015, është vërtetuar me këtë raport se drejtorja e administratës publike gjatë nënshkrimit të kontratave me TV lokale nuk i ka përfill procedurat e tenderimit. Me këtë provë fillimisht janë konstatuar shkeljet që janë bërë gjatë pagesave të ndryshme nga KK Prizren dhe drejtoritë përkatëse duke mos i respektuar procedurat ligjore të prokurimit publik. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove.

Nga kartela e furnitorëve lidhur me pagesat me TV Besën, TV Prizrenin dhe TV Opinionin, është vërtetuar se këto kartela më së miri tregojnë që shumica e objektit kontraktues është tejkaluara. Kjo provë përkon me të gjitha provat e administruara. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove.

Nga mendimi i ekspertizës së ekspertit financiar B.U e datës 26.04.2018, është vërtetuar se drejtoritë e Komunës së Prizrenit përfshirë edhe drejtorinë e administratës

së përgjithshme përmes drejtorëve të tyre, për emetimin e spoteve, transmetimin e seancave etj, kanë nënshkruar kontrata me radio televizionet lokale në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik të Kosovës nr. 04/L-042, ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive nr. 03/L-048 dhe rregullores së thesarit nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike për arsye se Komuna e Prizrenit në drejtoritë përkatëse është dashur që këto lloj shërbime ti realizoj përmes modulit - kërkesë për blerje duke i zbatuar procedurat tenderuese, gjë që në rastin konkretë nuk i ka zbatuar procedurat tenderuese. I akuzuari I.B, në cilësinë e drejtorit të drejtorisë së administratës së përgjithshme të Komunës së Prizrenit, gjatë vitit 2015 dhe 2016 ka paguar në emër të reklamave TV Opinion, TV Besa dhe TV Prizreni shumë prej 17.100 euro. Nga kjo shumë 15.000 euro, janë paguar në emër të drejtorisë së administratës së përgjithshme ndërsa 2100 euro, në emër të zyrës për informim. Kjo përkon me dëshminë dhe mendimin e ekspertit financiar A.Sh, i cili po ashtu ka theksuar se pagesat janë bërë në kundërshtim me ligjin e prokurimit dhe se në mes këtyre dy ekspertizave dallon vetëm vlera e pagesave ndërsa mendimi se si janë bërë këto pagesa është i njëjtë. Nga këto arsye gjykata ia fali besimin e plotë kësaj prove.

I akuzuari I.B në mbrojtjen e tij ndër të tjera ka theksuar se në cilësinë e drejtorit pranë Komunës së Prizrenit është punësuar me dt. 14.03.2014, dhe se gjatë punës si drejtor ka lidhur kontrata me TV lokale dhe se këtë punë e ka trashëguar nga paraardhësit të tij dhe se ky ka vazhduar këtë praktik për tu shërbyer qytetarëve, ato kontrata kanë qenë për ti informuar qytetarët me lehtësirat që i kanë ofruar si komunë dhe për ti dëgjuar dëgjimet publike të kryetarit të komunës me qytetarët për buxhetin e vitit paraprakë. Si komunë kanë ofruar aplikimin online për pesë dokumente të gjendjes civile që qytetarët kanë pasur mundësi që nga shtëpia të bëjnë aplikimin për këto dokumente të gjendjes civile, pas aplikimit qytetarit nga posta i ka shkuar ai dokument në shtëpi, të gjitha këto kanë qenë spote reklamuese për ti informuar qytetarët që si duhet të aplikojmë dhe se këto spote janë emituar në të tri mediat lokale duke mos e anashkaluar asnjërin. Kontratat janë lidh në periudhën mujore dhe atë me TV Opinion në vlerë prej 300 euro, TV Besën në vlerë prej 250 euro, dhe TV Prizrenin në vlerë prej 500 euro: Komuna e Prizrenit është një linje buxhetore e cila zyrtar kryesor financiar e ka kryetarin e komunës dhe 13 drejtori përkatëse, ka asamblenë që ka linje të veçantë të buxhetit. Komuna ka donacione grande qeveritare dhe subvencione dhe të hyrat vetanake dhe mallra shërbime të gjitha këto i nënshtrohen asamblesë komunale. Në kuadër të zyrës së prokurimit ekziston një zyre e cila merret me shumë deri në 990 euro, pa procedurë tenderuese të gjitha faturat e këtyre kontratave janë protokolluar në sportelet e komunës që së pari shkon në atë zyre që është në kuadër të zyrës së prokurimit pas marrjes së pëlqimit nga ajo zyre kalon tek zyrtari për informim që është në kuadër të kryetarit të komunës, merret pëlqimi prej tij pastaj vjen tek drejtori përkatës urdhër blerja e pagesës. Nuk kam qenë i informuar nga kompetentet që për këto pagesa duhet të shkohet në procedurë të tenderimit.

Nga mbrojtja e të akuzuarit I.B gjykata konstatoi se i akuzuari i ka pranuar në tërësi veprimet të cilat i ka ndërmarr, por i njëjti ka theksuar se praktika në Komunën e Prizrenit ka qenë e njëjtë dhe se ky ka vepruar njëjtë si drejtoritë e kaluara dhe se nuk ka qenë në dijeni se këto veprime janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik të Kosovës nr. 04/L-042, ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive nr. 03/L-048 dhe rregullores së thesarit nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike. Gjykata këtë mbrojtje të akuzuarit e hudh si të pa bazuar dhe në kundërshtim me provat e

administruara. Ngase deklarimi i tij se nuk ka qenë në dijeni dhe se stafi politik nuk është profesionist në këto lëmi nuk qëndrojnë. Për arsye se mosnjohja e ligjeve dhe e detyrave të punës, nuk e përjashtojnë përgjegjësinë penale, ngase për pozitën e drejtorit janë të parapara kushtet dhe kriteret e përcaktuara. Për këto arsye gjykata nuk ia fali besimin kësaj mbrojtje.

Bazuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor e të cilat janë elaboruar secila veç e veç dhe vlerësuar me ndërgjegje në pajtim me nenin 361 parag. 2 të KPP-së. Secila provë e administruar ka vërtetuar fakte të rëndësishme në këtë çështje penale. Me dëshmitë dhe mendimet e ekspertëve pa dyshim është vërtetuar se i akuzuari I.B në cilësinë e drejtorit të administratës publike pranë Komunës së Prizrenit ka nënshkruar kontrata me TV lokale, në kundërshtim me ligjin për prokurimit publik të Kosovës nr. 04/L-042, ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive nr. 03/L-048 dhe rregullores së thesarit nr.01/2013 për shpenzimin e parasë publike dhe se me këto veprime ka tejkalar kompetencat e veta dhe se nga këto veprime kanë përfituar në mënyrë të pa bazë duke mos iu nënshtruar konkurrencës respektivisht procedurës së tenderimit, nga e cila procedurë do të ishte vërtetuar se cila do ti kryente këto detyra më së miri dhe jo rastësisht kjo çështje është rregulluar me ligjin e prokurimit. Nga kontratat e nënshkruara çmimet e këtyre emetimeve dhe spoteve variojnë dhe asnjëra nga kontratat nuk ka shumë të njëjtë që i bie se në këtë rast ka edhe TV lokale që është angazhuar dhe paguar më pak ndërsa tjetra ma shumë. Me faturat e furnitorëve është vërtetuar më së miri se janë tejkalar shumat e objektit kontraktues nga i akuzuari dhe se këto fakte janë vërtetuar edhe me raportin e auditorit të vitit 2015, në të cilin raport është konstatuar se Drejtoria e Administratës Publike gjatë nënshkrimit të kontratave nuk i ka përfill procedurat e tenderimit dhe në bazë të këtij raporti paraja publike është keqpërdorur apo pagesat janë bërë pa kurrfarë procedure të tenderimit. Nga këto që u thanë më lartë pretendimet e të akuzuarit nuk qëndrojnë ngase në këtë çështje penale ka prova të mjaftueshme që i akuzuari ka qenë i obliguar ti zbatojë ligjet në fuqi dhe se pozita e drejtorit i ka kriteret dhe detyrat që duhet të përmbushen për tu emëruar në atë pozitë, e të gjitha këto në zbatimin e ligjit në favor të qytetarëve.

Gjykata nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor, duke e analizuar secilën provë veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku në tërësi ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar nga neni 422 parag. 1 lidhur me parag. 2 nën prag. 2.4 të KP-së, në atë mënyrë që i akuzuari me vetëdije të plotë dhe i vetëdijshëm për veprimet e veta ka kryer veprën penale për të cilën ngarkohet, andaj gjykata të njëjtin e ka shpallur fajtor për veprën penale dhe i ka shqiptuar dënimin me kusht duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 /gjashtë/ muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 /një/ viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër penale të re, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Gjykata ka analizuar me kujdes propozimin e mbrojtësi të akuzuarit që në cilësi të dëshmitarëve të ftohen dhe të dëgjohen K.G, H.H, E.S dhe N.K, i cili propozim është refuzuar nga trupi gjykues me arsyetim se dëshmitaret e propozuar kanë qenë të emëruar si drejtorë pranë Komunës së Prizrenit dhe se të njëjtit kanë vepruar njëjtë si i akuzuari, andaj me përgjigjet e dhëna në këtë shqyrtim ata do ta inkriminojnë veten apo pa e predikuar çështjen të njëjtit mund të jenë pjesë e ndonjë procedure penale për veprimet e tyre. Këto kanë qenë edhe arsyet e refuzimit të këtij propozimi.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe 74 të KP të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë renduese ka marrë mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe peshën e veprës penale. Si rrethanë lehtësuese është marrë sjellja korrekte para gjykatës, moshën e tij, gjendjen e tij ekonomike, shkollimin e tij, është hera e par që ballafaqohet me drejtësinë. Prandaj gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënimin me kusht sepse konsideron se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit, dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij penale dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahen nga veprimet e tilla. Ky dënim do të jetë edhe preventiv edhe për personat tjerë që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm me veprimet e tyre.

Nga të cekurat më lart, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet dhe tiparet e veprës penale për të cilën është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 453 par. 1 të KPP.

Nga të lartë cekurat u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i krimeve të Rënda
PKR.nr.111/17 me datë 25.05.2018
2018:010095, 25.05.2018

Procesmbajtësja
Flori Kolukaj

Kryetari i trupit gjyqësor,
Artan Sejrani

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.